



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 713 Prot.

Tiranë, më 04.072016

VENDIM Nr. 71, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të gjetjeve rastësore* në Kalanë e Gradishtës së Bellovës, realizuar nga ASHA dhe DRKK Shkodër-Sektori Dibër.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të gjetjeve rastësore* në Kalanë e Gradishtës së Bellovës.
2. DRKK Shkodër të marrë masa për mbulimin e sipërfaqeve ku janë zbuluar varret me qëllim shmangjen e dëmtimeve të tyre nga erozioni apo gërmimet klandestine.
3. Materiali skeletor i shpërndarë në sipërfaqe të mblidhet nga DRKK Shkodër dhe të depozitohet pranë fondeve të Institutit të Arkeologjisë.
4. Të vihet në dijeni INUV në lidhje me gërmimet klandestine të varreve në zonën e Kalasë së Gradishtës së Bellovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al